



01 Rregullat e reja të menaxhimit të sezonit veror, prioritet plazhet publike

Në vijim të vendimeve të mbledhjes së Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik, nga data 15 nëntor janë hapur në portalin eAlbania aplikimet për të gjitha subjektet private që disponojnë struktura akomoduese të certifikuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit që dëshirojnë të menaxhojnë stacione plazhi. Me ndryshimet ligjore në menaxhimin e stacioneve të plazheve, gjatë sezonit turistik veror 2025, në çdo 1 km vijë bregdetare, 300 metra do të jenë publike dhe do të menaxhohen nga bashkitë.



02 Projektbuxheti 2025: Fokusi në promovimin ndërkombëtar, në ekoturizëm dhe mjedis

Fokus i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2025 do të jenë zonat e mbrojtura dhe zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro prezantoi në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin buxhetin për vitin 2025, i cili ka një rritje prej 7.9% krahasuar me atë të vitit 2024. Investimet e brendshme për vitin 2025, rriten me 19% krahasuar me vitin 2024 ku dy janë investimet kryesore: Ngritja Infrastrukturore me theks ujor EKO-Park-Ulza dhe ndërtimi i Qendrës Multifunkionale në Lumin Vjosa.



03 10,4 milionë vizitorë të huaj deri në tetor

Përgjatë periudhës janar-tetor 2024 Shqipëria është vizituar nga 10,4 milionë vizitorë të huaj ose 16,2% më shumë se periudha janar-tetor e vitit të shkuar. Sipas të dhënave të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, gjatë muajit tetor vendin u vizitua nga 761 mijë vizitorë të huaj, ose 9,3% më shumë se tetori i vitit 2023. Në publikimin e fundit të Barometrit Global, Organizata Botërore e Turizmit e renditi Shqipërinë të parën në Europë dhe të dytën në botë sa i takon normës së rritjes së vizitorëve ndërkombëtarë.



04 Një projekt i ri ekoturistik i shtohet qytetit të Korçës

Një prej godinave të vjetra të qytetit të Korçës do të rijetëzohet, për t'u vënë në shërbim të administratës së Zonave të Mbrojtura të qarkut Korçë dhe si qendër multifunkionale në shërbim të komunitetit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Mirela Kumbaro ishte e pranishme në eventin e prezantimit të projektit të restaurimit arkitektonik dhe të rigjenerimit urban të hapësirave të reja, një projekt i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në kuadër të programit european Interreg IPA: "Industritë Kulturore dhe Kreative". Kjo hapësirë do të shërbejë edhe si një destinacion me rol edukues për të rinjtë, informacioni turistik, por edhe për organizimin e eventeve publike.



05 4.9 milionë vizitorë në zonat e mbrojtura, tregues i turizmit gjithëvjetor

4.9 milionë vizitorë janë regjistruar në zonat e mbrojtura nga janari në tetor të vitit 2024, ose 20% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Këto shifra tejkalojnë krejt vitin 2023, si prova më e qartë e shtrirjes së turizmit gjatë gjithë vitit, diversifikimit dhe zhvillimit të ekoturizmit, teksa vetëm gjatë muajit tetor janë shënuar 440 mijë vizitorë në zonat e mbrojtura. Sipas të dhënave nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 3,2 milionë vizita janë kryer nga qytetarë shqiptarë dhe 1,7 milionë nga vizitorë të huaj.